



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 1163/6 Prot.

Tiranë, më 15.03.2017

V E N D I M
Nr. 19, Datë 15.03.2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
AGJENCINË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE,
PROJEKTI “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE I” MBI “ZBATIMIN
E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKO - FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, Projekti “Infrastruktura Bashkiake I”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

1. Gjetje nga auditimi:

Për projektin “Infrastruktura bashkiake I” rolin e PIU-t e ka luajtur një koordinator i vetëm i ngarkuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, Tiranë, pa u ngritur struktura e PIU-t. Për këtë ndryshim të marrëveshjes financiare, nuk ka asnjë miratim nga palët nënshkruese të Marrëveshjes, ose ndonjë dokument ku të përcaktohen detyrimet që duhet të përmbush DPUK për implementimin e projektit, veprim në kundërshtim me Marrëveshjen financiare të ratifikuar me ligjin nr. 10413, datë 07.04.2011, kreu II pika 1.1.

Për këtë rekomandojmë:

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, të marrë masa për të ngritur një njësi të veçantë të zbatimit të projektit (PIU), me qëllim që stafi i njësisë të ndjekë dhe menaxhojë vetëm projektin “Infrastruktura bashkiake I” dhe “Infrastruktura bashkiake II”, sipas përcaktimeve në marrëveshjet e nënshkruara nga palët.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, ka kërkuar shtyrjen e afatit të realizimit të disbursimit për 3 vjet, pas vonesave fillestare në zbatimin e projektit. Shtyrja e afatit ka ardhur si pasojë e vonesave të aktiviteteve në krahasim me parashikimet fillestare, si:

- a) vonesat për moszbatimin e kushteve të vendosura për ndërmarrjet e ujit nga KfW, në lidhje me mbulimin e kostove operative,
- b) ndërmarrjet e ujit para fillimit të punimeve nuk plotësonin parakushtin se para kontraktimit të punimeve duhet të jetë propozuar dhe aprovuar nga bashkitë respektive dhe dorëzuar tek ERRU propozimi i rritjes së tarifave të vendosura nga KfW,
- c) mos përfshirja e konsulentit institucional në grafikun fillestar të aktiviteteve të programit, i cili do të mbështeste shoqëritë në proceset e hartimit të plan biznesit, duke përfshirë konceptin e ndryshimit të tarifave për mbulimin e kostove dhe parakushteve të vendosura nga KfW.

Për këtë rekomandojmë:

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, të marrë masa për projektet në vazhdim, që përpara fillimit të zbatimit të projekteve të sigurojnë realizimin e kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë, me qëllim arritjen e përfundimit të projektit në kohën e caktuar.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Procedurat e tenderimit nga ndërmarrjet e ujit për “matësit e ujit”, nuk janë kryer të kombinuara por veçmas për çdo qytet, në kundërshtim me pikën II. 3. 3. 2, të Marrëveshjes së veçantë, “Zbatimi i programit”, ku është përcaktuar se përveç tenderimit të “matësve të ujit” që do të jetë i kombinuar për të katër qytetet, të gjitha kontratat e tjera për mallrat dhe shërbimet do të jepen veçmas nga ndërmarrjet e veçanta të ujit në qytetet e Fierit, Gjirokastrës, Lezhës dhe Sarandës.

Për këtë rekomandojmë:

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, të marrë masat që në të ardhmen për projektet në vazhdim në bashkëpunim me ndërmarrjet e ujit, të kryejnë procedura tenderimi në përputhje me përcaktimet në Marrëveshjet e Huasë, me qëllim arritjen e prokurimit të mallrave me kosto sa më të ulët, referuar specifikimeve teknike të kërkuara.

Në vazhdimësi

Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

4. Gjetje nga auditimi:

Për zbatimin e Projektit “Programi i Infrastrukturës Bashkiake I - në Qytetet Fier, Gjirokastrë, Sarandë, Lezhë” është nënshkruar kontrata me konsulentin institucional H. N. B.V për shërbimet e konsulencës për periudhën Shtator 2011 - Shtator 2014, e cila ka filluar punën me vonesë pasi shoqëritë përfituese të ujësjellës kanalizimeve, nuk kishin dijeni për domosdoshmërinë e shërbimeve të këtij konsulenti.

Për këtë rekomandojmë:

Nevoja e shërbimeve të konsulencës institucionale për Njësinë e Zbatimit të Projektit si dhe për shoqëritë përfituese të projekteve përkatëse të përcaktohet saktë dhe me rigorozitet në momentin e hartimit dhe lidhjes së marrëveshjes së financimit, me synim eliminimin e vonesave në implementimin e projekteve.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Gjatë viteve 2011-2015 janë kryer vetëm shërbime konsulence për implementimin dhe fuqizimin institucional, pasi në këtë periudhë nuk ka patur kontratë me operatorë privatë për zbatimin e punimeve. Disbursimi për punimet është kryer në ritme shumë të ulëta deri në vitin 2014 dhe më pas ka pësuar rritje në vitet 2015-2016, si rrjedhojë e implementimit të ngadaltë të kontratave të punimeve civile, kjo ka sjellë edhe shtyrjen e afatit të disbursimit deri në vitin 2018.

Me miratimin e Ligjit Nr. 12/2016 “Për ratifikimin e ndryshimeve në Marrëveshjen e Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW F A M për financimin e Programit “Infrastruktura Bashkiake I- Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime për qytetet Lezhë, Gjirokastrë, Sarandë, Fier” për shtyrjen e afatit të disbursimit të fondeve nga dhjetor 2016 deri dhjetor 2018, nuk është përcaktuar skema e disbursimit të fondeve në ligjin e miratuar.

Për këtë rekomandojmë:

Të kërkohet nga Organet Përkatëse miratimi i skemës disbursuese për 2 vitet e ardhshme dhe të bëhen përpjekjet maksimale për përfundimin e punimeve në kohë dhe në cilësi sipas projektit të zbatimit për mënjanimin e shtyrjeve të tjera.

Në vazhdimësi

Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i 4 procedurave të prokurimit me objekt “Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Fier, Lezhë, Gjirokastrë dhe Sarandë”, u konstatua se publikimi i tenderit nuk është bërë në Shqipëri, as në media lokale ose në gazeta të përditshme siç shprehet dhe në udhëzuesin e KfW për procedurën e prokurimit, në kundërshtim me udhëzuesin e bankës pika 2.02, paragrafi i 3-të.

Gjithashtu në lidhje me vlerësimin e ofertave konstatohet se në të 4 procedurat e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Fier, Lezhë, Gjirokastrë dhe Sarandë”, vlerësimi ofertave është bërë nga titullarët përkatës dhe dy përfaqësues të konsulentit S., pra nuk është vepruar në përputhje me Ligjin nr. 10413, datë 07.04.2011, Kreu II-Zbatimi i programit, pika 2.1.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit të kryer në UK Fier u konstatua se është bërë në mënyrë të padrejtë s’kualifikimi i operatorit ekonomik “L.P

GMBH”, pasi ky operator ka paraqitur në stafin teknik të njëjtët persona të cilët janë angazhuar në një projekt tjetër. Ofertuesi ka sjellë shkresë se nëse shpallet fitues i këtij tenderi, do ta zëvendësojë stafin e paraqitur me një staf tjetër ekuivalent. Drejtuesit e nuk kanë kërkuar më tepër shpjegime në lidhje me konstatimet e mësipërme, për të menaxhuar më mirë vendimmarrjet e anëtarëve të Komisionit të Procedurës së Prokurimit për të shmangur këto problematika.

Për këtë rekomandojmë:

Nga AKUK të merren masat për të ardhmen, për projektet në vijimësi, të zbatohen me përpikmëri përcaktimet e udhëzuesve të bankave financuese me synim rritjen e pjesëmarrjes më të gjerë të ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Në vazhdimësi.

7. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me raportet e vlerësimit dhe shpjegimet përkatëse të hartuara gjatë procesit të procedurave të prokurimit në të 4 qytetet, për projektin me objekt “Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Fier, Lezhë, Gjirokastrë dhe Sarandë” u konstatua se gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë në gjuhën angleze, duke mos respektuar Kushtetutën e Shqipërisë pasi është vepruar në kundërshtim me nenin 14 në të cilin citohet se “Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja”, si dhe asnjë raport nuk është paraqitur në shqip siç përcaktohet në termat e referencës së kontratës së konsulentit pika 2.1.2, pasi nuk u paraqit asnjë raport në shqip, gjë e cila nuk është kërkuar as nga drejtuesit e Projektit.

Për këtë rekomandojmë:

Nga AKUK si dhe nga Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime Fier, Lezhë, Gjirokastrë dhe Sarandë, në lidhje me projektet me financime të huaja, të hartohet dhe mbahet një kopje e përkthyer e dokumentacionit të projektit, pasi i gjithë dokumentacioni dhe investimi do të merret në dorëzim nga shoqëritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

8. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me inventarizimin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit për tenderin me objekt “Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Fier”, u konstatua se dokumentacioni i dosjes së kësaj procedure tenderi nuk është e inventarizuar në kundërshtim me nenin 30, modeli nr 8 ”Normat tekniko-profesionale dhe metodologjisë së shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga DP e Arkivave, në zbatim të neneve 3 e 29 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtorja e Ujësjellës Kanalizime Fier, të marrë masat për përmirësimin e punës dhe mbajtjen e dokumentacionit përkatës, në lidhje me procesin e inventarizimit të çdo lloj dokumentacioni të këtij projekti, në përputhje me ligjet në fuqi.

Brenda datës 31.03.2017.

Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

a. Mbi auditimin e zbatimit të Kontratës së punimeve civile “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Qytetin Fier”.

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratës së punimeve civile Rehabilitimi i rrjetit të Ujësjellësit Qytet Fier konstatohet se, deri në fund të muajit dhjetor 2016 koha e kaluar nga fillimi i punimeve është 90 %, realizimi financiar është në shumën 7,747,436 Euro ose 77 %.

Me këtë angazhim të kontraktorit punimet e kontratës nuk do të përfundojnë në afatin e përcaktuar në kontratë. Duke krahasuar grafikun e miratuar të punimeve janë më të vonuara punimet për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në Qytetin Fier, rrjeti kryesor i këtij qyteti dhe rrjeti i kanalizimeve. Po ashtu është me shumë vonesë ndërtimi i rezervuarit të ri në Cerven.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i Punimeve të marrë masa dhe t'i kërkojë Kontraktorit paraqitjen e një grafiku të ri të punimeve për kontratën që po realizohet në Qytetin e Fierit, me synim rritjen e angazhimit në realizimin e punimeve dhe përfundimin në afat të tyre, për vënien e plotë në eficiencë të investimit sipas afatit të parashikuar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Pjesë e kontratës është blerja e një ekskavatori i cili është propozuar model “3CX E C”. Vlera e këtij mekanizmi është likuiduar në certifikatën e parë të pagesës. Autorizimi për marrjen në dorëzim të mekanizmit është lëshuar në vitin 2015. Nga auditimi rezulton se ky automjet ka paraqitur defekte të përsëritura gjatë përdorimit.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i Punimeve në bashkëpunim me Shoqërinë UK Fier, të marrin masa për përcaktimin e arsyeve që ekskavatori i furnizuar nuk ka funksionuar normalisht dhe të nxjerrin përgjegjësitë përkatëse duke marrë masa për riparimin e tij, me synim vënien e plotë në eficiencë të këtij mjeti.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

Pjesë e kontratës është blerja e një kamioni Tip Iveco, autorizimi për tërheqjen e automjetit mban datën 01.11.2016. Janë ngarkuar z. K.P dhe z. E.P për tërheqjen e kamionit.

Nga verifikimi i specifikimeve teknike si dhe i dokumentacionit të automjetit rezulton se është përcaktuar që vinçi (i montuar në kamion) duhet të jetë i markës EFFER 100.4 S, ndërsa rezulton që automjeti ka të montuar vinç të markës FASSI, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i Punimeve të marrë masa për analizimin e shmangieve sa i takon respektimit të specifikimeve teknike dhe prodhuesit për vinçin e montuar në kamionin Tip Iveco. Të verifikohet vlera e tregut për këtë vinç, duke bërë zbritjet e vlerës përfituar padrejtësisht nga kontraktori si pasojë e mos furnizimit të tij, sipas markës së propozuar në dokumentet e tenderit.

Brenda datës 31.03.2017

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i disa zërave të punimeve kryesisht për rrjetin shpërndarës të Qytetit Fier, sipas lot 1, rezulton se janë realizuar punime pa cilësi sa i takon lidhjeve shtëpiake. Rehabilitimi në disa raste nuk është bërë sipas specifikimeve. Këto defekte konstatohen kryesisht në tubacionet të cilat përshkojnë trotualet e ndërtesave të shtruara me pllaka, por edhe në trotualet e shtruara me beton apo asfaltobeton.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i Punimeve t'i kërkojë Kontraktorit riparimin e defekteve sa i takon lidhjeve të banesave. Të merren masa për riparimin e trotuareve dhe shtresave rrugore sipas specifikimeve teknike të kontratës.

Gjatë zbatimit të kontratës

b. Mbi auditimin e zbatimit të Kontratës së punimeve civile “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Qytetin Lezhë”.

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur në zbatimin kontratës së punimeve civile “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Qytet Lezhë u konstatua se, ka vonesë të theksuara sa i takon fillimit dhe realizimit të punimeve elektrike të sistemit SCADA, si dhe në sistemin e kanalizimeve. Po ashtu me mosrealizim është loti 4, i cili ka të bëjë me furnizimin e pajisjeve dhe makinerive.

Janë realizuar 75.5 % e punimeve, ndërkohë që koha e koha e konsumuar e kontratës është 91.6 %, pa marrë në konsideratë shtyrjen e afatit të aprovuar.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i Punimeve të marrë masa dhe t’i kërkojë Kontraktorit paraqitjen e një grafiku të ri të punimeve për kontratën që po realizohet në Qytetin e Lezhës, me synim rritjen e angazhimit në realizimin e punimeve dhe përfundimin në afat të tyre, për vënien e plotë në eficiencë të investimit sipas afatit të parashikuar.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi:

Punimet për ndërtimin e linjave, të depove, furnizimin e automjeteve etj., janë realizuar nga nënkontraktori “J” Sh.p.k. Kontraktori “S.E”, ka nënkontraktuar më shumë se 30 % të punimeve të kontratës, veprim në kundërshtim me Kushtet e Veçanta të Kontratës Pikën 4.4 ku përcaktohet se: “Nënkontraktimi nuk është i lejuar për më shumë se 30 % të vlerës së kontratës”.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i punimeve të marrë masa për pasqyrimin e punimeve të cilat nënkontraktohen nga kontraktorët. Të kërkohej respektimi i kushteve të kontratës, mbi përqindjen e nënkontraktimit nga Kontraktorët që kanë fituar tenderin dhe kanë nënshkruar kontratën përkatëse, jo vetëm për Qytetin e Lezhës, por edhe për 3 qytetet e tjerë pjesë e projektit.

Brenda datës 31.03.2017

15. Gjetje nga auditimi:

Në kontratën e nënshkruar është parashikuar blerja e 3 automjeteve kamionçinë (Pick up) dhe një autoveturë foristradë (SUV), me vlerë 25,000 Euro për mjet. Nga auditimi rezulton se pagesa për këto automjete është realizuar plotësisht. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Kontraktori, automjetet rezultojnë në pronësi të nënkontraktorit “J” Sh.p.k.

Nga auditimi rezulton se automjeti SUV “Scoda Yeti” i furnizuar nga Kontraktori nuk është në përputhje me përcaktimet kontraktore. Ky automjet duhet të furnizohej me karakteristika të njëjta me “TOYOTA Hilux”. Automjeti i furnizuar nuk ka karakteristika të njëjta sa i takon peshëmbajtjes dhe elementë të tjerë. Referuar specifikimeve teknike të kontratës, automjetet si më sipër duhet të vihen në dispozicion të UK Lezhë, e cila duhet ta merrte në dorëzim. Një automjet i tillë nuk përmbush nevojat e kësaj ndërmarrje për përdorim si dhe ka amortizim më të shpejtë se automjeti i përshkruar në dokumentet e tenderit.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i punimeve të përlllogarisë vlerën e shpenzuar nga kontraktori dhe të bëhen zbritjet përkatëse, duke vlerësuar vlerën e tregut sipas karakteristikave apo markës së automjetit.

Gjatë zbatimit të kontratës

16. Gjetje nga auditimi:

Në kontratë është parashikuar edhe furnizimi i një autoboti pastrimi, i një ekskavatori dhe një kamioni me vinç.

Rezulton se nga këto tre mjete është furnizuar vetëm ekskavatori me vlerë 63,000 Euro, vlerë e cila është likuiduar. Automjetet ishin parashikuar të viheshin në dispozicion të Shoqërisë UK Lezhë, për përmirësimin e aktivitetit të saj, duke krijuar në këtë mënyrë mungesë efektiviteti të fondeve të parashikuara për këtë qëllim. Ato rezultojnë në pronësi të Kontraktorit dhe nuk janë regjistruar në UK Lezhë, sipas specifikimeve teknike ku përcaktohet se regjistrimi i automjeteve do të bëhet në bashkëpunim me Ujësjiellës-Kanalizime SHA Lezhë.

Për këtë rekomandojmë:

Mbikëqyrësi i Punimeve të kërkojë nga kontraktori furnizimin e mjeteve sipas përcaktimeve kontraktore, me synim vënien në përdorim të tyre në dobi Ujësjiellës Kanalizime SHA Lezhë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik me vlerë 170,739 Euro, e cila në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Janë paguar 500 Euro për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nga operatorët ekonomik të cilët kanë shfaqur interes për pjesëmarrje në tender për projektin “Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjiellës dhe Kanalizimeve në Fier, Lezhë, Gjirokastrë dhe Sarandë”, u konstatua se këto pagesa janë kryer për llogari të Konsulentit, dhe konkretisht për tenderin e zhvilluar në UK Sarandë 5,000 Euro, për tenderin e zhvilluar në UK Fier 5,100 Euro, për tenderin e zhvilluar në UK Gjirokastrë 5,500 Euro për tenderin e zhvilluar në UK Lezhë 9,100 Euro pra në total shuma prej **24,700 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga konsulenti “S.E”.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit të marrë masa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga Konsulenti në shumën 24,700 Euro, duke e zbritur nga pagesat e konsulentit dhe arkëtimin në llogarinë e projektit.

Menjëherë

a. Mbi zbatimin e kontratës së Ujësjiellës Fier.

2. Gjetje nga auditimi:

- Materialet e përcaktuara sipas kontratës që kanë të bëjnë kryesisht me tubacionet por edhe aksesorët e tjerë si saraçineska, fllanxho, reduktorë etj., nuk janë blerë nga kontraktori në vendet e paraqitura në dokumentet e tenderit, vende të origjinës së përcaktuar, por janë blerë në Shqipëri, nga Firma “V” Sh.p.k. Nga auditimi rezulton se sipas zërit Lot 1, Bill 2, pika 2.9 është likuiduar vlerë por transportimin e materialeve nga jashtë vendit (CIP) dhe shpenzime doganore me vlerë 30,984 Euro.

Sa më sipër, në kushtet kur materialet janë blerë brenda vendit, shpenzimet e transportit dhe ato doganore, nuk justifikohen nga kontraktori. **Vlera 30,984 Euro është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.**

Nga auditimi rezulton se sipas zërit Lot 1, Bill 2, pika 2.9 është likuiduar vlerë por transportimin e materialeve nga jashtë vendit (CIP) dhe shpenzime doganore me vlerë 20,984 Euro.

Sa më sipër, në kushtet kur materialet janë blerë brenda vendit, shpenzimet e transportit dhe ato doganore, nuk justifikohen nga kontraktori. **Vlera 20,984 Euro është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.**

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti, të marrin masa për zbritjen e vlerës 51,968 Euro, nga pagesat e Kontraktorit "A" Sh.p.k, përfituar padrejtësisht për pagesë transporti nga jashtë vendit, ndërkohë që materialet janë blerë në Shqipëri.

Gjatë hartimit të certifikatës së pagesës pasardhëse.

3. Gjetje nga auditimit:

Bazuar në certifikatën e pagesës nr. 6, LOT 1, Bill 2, Pika 2.8 "Miscellaneous" Pika 2.8.2 "Kuti sahat matës, plastike", janë parashikuar të vendosen 600 kuti, ndërsa janë likuiduar 700 copë. Nga verifikimi në terren rezulton se kutitë e vendosura nuk janë me material plastik por metalike me dimensione 60 cm x 40 cm. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike. Çmimi për njësi është 50.56 Euro/copë. Referuar të njëjtit material dhe përmasave, për qytetin e Lezhës, këto kuti janë furnizuar me çmim 46.22 Euro/copë. Duke marrë në konsideratë faktin se materiali nuk është në përputhje me specifikimet teknike sa i takon materialit të prodhimit, si dhe faktin se në dokumentet e tenderit nuk janë paraqitur specifikime teknike sa i takon përmasave. Vlera e likuiduar për këto kuti është 82,918 Euro (1640 copë x 50.56 Euro/copë), sa i takon kutive dhe për kapakët e tyre është likuiduar vlera 1640 copë x 7.22 Euro/copë). Referuar kontratës së realizuar në Qytetin e Lezhës sipas këtij projekti (pasi në kontratën përkatëse nuk ekziston zëri furnizim vendosje kuti metalike) rezulton se janë kontraktuar blerje kuti metalike me të njëjtat specifikime me çmim 46.22 Euro për copë. ***Rezulton se është likuiduar më tepër vlera 24,414 Euro [1760 copë x (57.78-46.22) + TVSH], vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.***

Sa i takon vendosjes së këtyre kutive, është likuiduar sasia 1000 copë me çmim 14.04 lekë për copë. Referuar kontratës së realizuar në qytetin e Lezhës për këtë zë punimi rezulton se është likuiduar me çmim 5.46 Euro për copë. ***Vlera për vendosjen e kutive metalike në shumën 10,296 Euro [1000 copë (14.04 - 5.46) Euro + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.***

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për zbritjen e vlerës 34,710 Euro, nga pagesat e Kontraktorit "A" Sh.p.k, përfituar padrejtësisht si rezultat i furnizimit dhe vendosjes së kutive të sahatëve matës, në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës.

Gjatë hartimit të certifikatës së pagesës pasardhëse.

4. Gjetje nga auditimi:

Në kontratë është parashikuar blerja e automjeteve për përdorim të konsulentit gjatë zbatimit të kontratës. Nga ana e konsulentit u vu në dispozicion të auditimit një kontratë huapërdorje e një automjeti Tip Mitsubishi L 200 (ATP Pick Up), nënshkruar me datë 22.10.2015, pra e përdorur nga konsulenti për një periudhë 9 muaj, referuar pagesës nr. 6, që përfshin aktivitetin e projektit deri me datë 31.07.2016. Nga verifikimi i pagesave për këtë periudhë rezulton se, sipas zërit bill 1 (të përgjithshme) Pika 1.2.3 "Kosto operationale për transportin e stafit të konsulentit", është likuiduar periudha 14 muaj, me çmim mujor 700 USD në muaj. Sa më sipër rezulton se është likuiduar më tepër për periudhën 5 mujore. ***Vlera 4,200 Euro (700 Euro x 5 muaj + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga Konsulenti "A" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik. Për këtë veprim mban përgjegjësi Konsulenti "S.E GMBH & Co.Kg".***

Në specifikimet e kontratës seksionin IX, Pika 14.2.1 "Automjete" përcaktohet: "Kontraktori duhet të sigurojë dy automjete të reja për përdorim të konsulentit dhe stafit të tij. Regjistrimi i automjeteve do të organizohet përmes UKF. Pas përfundimit të kontratës

automjetet do të dorëzohen tek UKF në kushte optimale”. Automjetet duhet t’i dorëzohen konsulentit brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës.

Sa më sipër, shpenzimet e likuiduara për blerjen e këtij automjeti, ndërkohë që automjeti është vënë në përdorim me kontratë huapërdorje, nuk justifikon blerjen e tij. PAGESA PËR BLERJEN E AUTOMJETIT ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME KONTRATËN DHE BAZUAR NË ZËRIN BILL 1 (TË PËRGJITHSHME) PIKA 1.2.2, ***vlera 24,000 Euro (20,000 Euro+TVSH) e likuiduar për këtë automjet është e pa justifikuar dhe përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A” Sh.p.k.***

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për zbritjen e vlerës 28,200 Euro nga pagesat e Kontraktorit “A” Sh.p.k, përfituar padrejtësisht për pagesë automjeti i cili nuk është blerë, si dhe shpenzime transporti të pa justifikuar për automjetin i cili është përdorur me kontratë huadhënie.

Gjatë hartimit të certifikatës së pagesës pasardhëse.

5. Gjetje nga auditimi:

Bazuar në certifikatën e pagesës nr. 6 dhe nr. 7 dhe 8 (Lot 1, bill 2), janë blerë dhe vendosur tubacione më shumë nga përcaktimi në kontratë. Blerja dhe pranimi i tubacioneve të cilat nuk janë pjesë e projektit është në kundërshtim me kontratën. Deri në momentin e auditimit, për këtë lot nuk është vendosur e plotë sasia e tubave të përshkruar në projektin e zbatimit. Në këto kushte, ***vlera 22,761 Euro (18,967.5 + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A” Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.***

Ndryshimi i sasive të tubacioneve është shoqëruar me rritje të çmimit të kontratës, veprim i cili duhet të realizohet me miratimin e punëdhënësit (UK Fier) sipas specifikimeve të veçanta të kontratës Pika 3.1 (b)(ii) ku përcaktohet “Ndonjë ndryshim që rezulton në rritje të çmimit të kontratës së pranuar do të kërkojë miratimin e punëdhënësit (UK Fier) dhe miratimin e KfW”.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për zbritjen e vlerës 22,761 Euro, nga pagesat e Kontraktorit “A” Sh.p.k, përfituar padrejtësisht për furnizim tubacione mbi sasinë e përcaktuar në kontratë, të cilat bëhen të pa nevojshme gjatë realizimit të saj.

Gjatë hartimit të certifikatës së pagesës pasardhëse.

6. Gjetje nga auditimi:

Bazuar në specifikimet teknike Pika 14.1.1 “Zyra dhe facilitete” është përcaktuar se kontraktori do të sigurojë ambiente zyrash të përkohshme për përdorim të klientit dhe konsulentit teknik në një sipërfaqe minimale 90 m², e përbërë nga 3 zyra dhe 1 zyrë mbledhësh në katin përdhe ose në katin e parë. Nga auditimi rezulton se nga ana e kontraktonit është siguruar një ambient në katin e katërt të një pallati me sipërfaqe 63 m² e përbërë nga dy dhoma, njëra e përshtatur si zyrë. Ky veprim nuk përmbush specifikimet e mësipërme. Sipas zërit Bill 1 “Të përgjithshme” Pika 1.1. është likuiduar vlera 11,000 Euro, që i përket pagesës respektive për një periudhë 11 muaj. Duke marrë në konsideratë mos respektimin e specifikimeve teknike për sipërfaqen e objektit që duhet të vihet në dispozicion, rezulton se si pasojë e vënies në dispozicion të një ambienti më me pak sipërfaqe edhe shpenzimet duhet të likuidoheshin në përputhje me sipërfaqen e vënë në dispozicion. Në këto kushte pagesa e realizuar kontraktorit për këtë qëllim duhet të reduktohet në masën 30 % me vlerë 3,960 Euro [(11,000 x 30 %) + TVSH]. ***Vlera 3,960 Euro është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.***

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për zbritjen e vlerës 3,960 Euro, nga pagesat e Kontraktorit “A” Sh.p.k, përfituar padrejtësisht si pasojë e mos

sigurimit të ambienteve të zyrave për përdorim të konsulentit, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të kontratës.

Gjatë hartimit të certifikatës së pagesës pasardhëse.

Kontrata ujësjellës Lezhë

7. Gjetje nga auditimi:

Në minutat e takimit të datës 17.03.2015, Inxhinieri ka deklaruar se nuk janë plotësuar kushtet e punës në zyrat e inxhinierit. Pavarësisht se deri në këtë datë nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara në kontratë, pagesa për këtë shërbim është realizuar. ***Pagesa e realizuar sipas zërit Faturë 1, Pika 1.2.1 për muajin shkurt dhe mars me vlerë 1,440 Euro 1,200 Euro + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga kontraktori.***

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për zbritjen e vlerës 1,440 Euro, nga pagesat e Kontraktorit "S" Sh.p.k, përfituar padrejtësisht nga mos sigurimi i kushteve të punës në ambientet e zyrave për përdorim të konsulentit.

Gjatë hartimit të certifikatës së pagesës pasardhëse.

C. PËRDORIM PA EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE.

Gjatë auditimit është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve me vlerë 239,698 Euro, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit në UK Fier u konstatua se gjatë procesit të tenderit është kryer një vlerësim i ofertave financiare për 3-operatorët e kualifikuar. Më pas është pezulluar procesi duke vepruar me ndryshime në afatin e zbatimit të punimeve dhe duke vazhduar më tej me vlerësimin e ofertave të paraqitura nga po të njëjtët operatorë. Si rezultat i ndryshimeve të afateve kohore në dokumentet e tenderit pasi është kërkuar që afati i punimeve nga 24 muaj, të ulet në 20 muaj, në lidhje me këtë projekt shtetit shqiptar i është krijuar një efekt financiar negativ me vlerë **192,672 Euro me TVSH.**

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit, për projektet në vazhdimësi të marrë masat e duhura për parashikimin e afateve dhe fondeve në dispozicion para fillimit të procedurave të prokurimit, me qëllim shmangien e humbjeve financiare dhe vonesave që vijnë si pasojë e tyre.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi:

Gjatë auditimit të zbatimit të kontratës së Rehabilitimit të Ujësjellës Lezhë, rezultoi se, është realizuar kosto transporti për automjetet e inxhinierit për tre automjete për një periudhë kohore 50 muaj. Bazuar në specifikimet teknike këto automjete do të viheshin në dispozicion të stafit të Inxhinierit në kontrollin e punimeve, pra në terrenin e punimeve sipas kontratës. ***Nga auditimi rezulton se vetëm dy automjete kanë qenë në disponim të Inxhinierit sipas përcaktimit të mësipërm, ndërsa një automjet është përdorur nga stafi drejtues i kompanisë konsulente. Bazuar në sa më sipër, vlera e likuiduar 15,360 Euro (16 muaj x 800 Euro + TVSH) përbën shpenzime pa efektivitet të fondeve.***

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për vënien e automjetit në dispozicion të stafit të supervizionit në terren, sipas përcaktimeve në kontratën përkatëse.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Bazuar në certifikatën e pagesës sipas lot 1, Bill 2.1, pika 2.8 (miscellaneous) Pika 2.8.3.1 janë parashikuar për t'u vendosur 1800 kuti sahati plastike, me VO 1 janë shtuar edhe 600 copë, ndërsa janë likuiduar 100 copë me çmim 30.2 Euro për copë. (Pagesë për material). Nga verifikimi i zërit vendosje Lot 1, Bill 2.2, Pika 5.8 (miscellaneous) Pika 5.8.3.1, rezulton se është vendosur vetëm një kuti sipas përcaktimit të mësipërm me çmim 6.42 Euro për copë.

Lot 1 Bill 2.2 "Furnizim vendosje sahte matës domestik" Pika 2.2.10.1 janë parashikuar të vendosen 1100 kuti të sahteve matës (për pallate 5 kate), me VO 1, janë shtuar 1000 copë, ndërsa janë likuiduar 4286 copë me çmim 46.22 Euro për copë (Pagesë për material). Nga verifikimi i pagesës për vendosje sipas zërit Lot 1, Bill 2.2, Pika 5.2.10 rezulton se është likuiduar vendosja e tyre në sasinë 1713 copë me çmim 5.46 Euro për copë.

Nga auditimi i dokumentacionit për materialet e mësipërme rezulton se në dokumentet e tenderit nuk janë përcaktuar specifikimet teknike sa i takon kutive metalike, por vetëm për kutitë plastike. Janë parashikuar dhe janë shtuar sipas Urdhër ndryshimit nr. 1 2400 kuti plastike dhe 2200 kuti metalike, ndërkohë që janë furnizuar dhe vendosur 100 kuti plastike dhe 4286 kuti metalike. Nga përlllogaritjet rezulton se nga parashikimi duhet të realizoheshin furnizim vendosje kuti me vlerë 169,542 Euro, ndërsa sipas faktit janë shpenzuar 210,118 Euro. Kutitë e parashikuara për t'u vendosur kryejnë të njëjtin funksion. Ndryshimi i sasisë korrespondon me ndryshim të çmimit të kontratës. Ky ndryshim duhet të bëhej me miratimin e UK Lezhë, përcaktimit të pikës 3.1 (b)(ii) të kushteve të veçanta të kontratës ku përcaktohet "*Ndonjë ndryshim që rezulton në rritje të çmimit të kontratës së pranuar do të kërkojë miratimin e punëdhënësit (UK Lezhë) dhe miratimin e KfW*".

Nga veprimi i mësipërm është rritur kosto e projektit në vlerën 31,576 Euro (201,118 Euro-169,542 Euro), vlerë e cila përbën përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe objektivitet të fondeve.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Koordinimit të Projektit dhe Supervizori të marrin masa për vendosjen e sahteve matës plastike në zonat ku nuk ka përmbytje, me qëllim minimizimin e rritjes së kostos së projektit.

Gjatë zbatimit të kontratës përkatëse

D. MASA DISIPLINORE

Raporti Përfundimtar i Auditimit, Vendimi përkatës dhe rekomandimet, të analizohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe të fillojnë procedurat për dhënie mase disiplinore për personat përgjegjës.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R